



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 /2008, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, pika “ç” të Statutit të Komunës, si dhe vendimin e Kuvendit të Komunës 01nr. 177/20, dt. 24.09.2020. për aprovim të buxhetit për vitin 2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur mars 2021 mori këtë:

**VENDIM
PËR SHPËRNDARJE TË MJETEVE FINANCIARE NGA SUBVENCIONET DHE
TRANSFERET PËR VITIN 2021**

1. Me këtë vendim mjetet financiare të buxhetit të Komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2021 në shumë të përgjithshme prej **790,000.00€**, shpërndahen sipas pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.1 Zyra e Kryetarit:

1.1.1	Subvencione për dekorata.....	30,000.00 €
1.1.2	Subvencione për raste të veçanta (për kompensimin e bizneseve, fatkeqësive natyrore etj).....	140,000.00 €
	Gjithsej.....	170,000.00 €.

1.2. Zyra Komunale për Komunitete (ndihmë për të riatdhesuar).....5,000.00 €.

1.3. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (Subvencionimi i projekteve në bujqësi).....145,000.00 €.

1.4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

1.4.1.	Ndihmë për strehim – qiratë e banimit	20,000.00 €
1.4.2.	Ndihmë për shërim.....	28,000.00 €
1.4.3.	Ndihmë për familje skamnore.....	10,000.00 €
1.4.4.	Financim të OJQ – ve.....	27,000.00 €
1.4.5.	Bashkëfinancim me donatorë për familje të pastrehë.....	15,000.00 €
1.4.6.	Kompensimi për fëmijët e porsalindur si dhe për të infektuarit nga pandemia Covid-19.....	180,000.00 €
	Gjithsej.....	280,000.00 €

1.5. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

1.5.1. Botimi i Librave – publikimeve	5,000.00 €
1.5.2. Financimi i OJQ- ve	125,000.00 €
1.5.3. Teatri i qytetit	10,000.00 €
Gjithsej.....	140,000.00 €

1.6. Drejtoria për Arsim

1.6.1. Bursa për studentë.....	22,000.00 €
1.6.2. Transport për fëmijë me nevoja të veçanta.....	18,000.00 €
1.6.3. Bursa për nxënës të klasës së X –të, drejtimi – saldues dhe përpunues i drurit në SHMT “Lutfi Musiqi”	5,760.00 €
1.6.4. Shpërblime për nxënës	4,240.00 €
Gjithsej.....	50,000.00 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUČITRIN

01 Nr. / Br 65/21

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data / Datum 25.03.2021

VUSHTRRI - VUČITRIN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" në lidhje me nenin 40, paragrafi 2 shkronja "c" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 9 pika 1.2 të Ligjit Nr. 07/L-001 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020, si dhe në bazë të nenit 41, paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 mars 2021** mori këtë:

VENDIM

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2020 NË VITIN 2021

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje.....	1,333.80 €
1.2 Mallra dhe shërbime	601,064.11 €
1.3 Shpenzimet komunale.....	25,341.22 €
1.4 Subvencionet dhe transferet.....	225,304.93 €
1.5 Investime kapitale.....	936,207.77 €
Totali i mjeteve të bartura.....	1,789,251.83 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale, dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br. 71/21
Nr. i fq. / Br. sh. -1-
Data: / Datum 25.03.2021
VUSHTRRI - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” në lidhje me nenin 69 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **25 mars 2021** merr këtë:

**VENDIM
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT**

1. Me këtë vendim themelohet komisioni i përbashkët kuvend-qeveri komunale në përbërjen si në vijim:

- 1.1. Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit;
- 1.2. Ali Januzi, anëtar i kuvendit;
- 1.3. Agim Kraniqi, anëtar i kuvendit;
- 1.4. Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë së Inspektimeve dhe
- 1.5. Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të ketë për detyrë, që në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës Dega në Vushtrri, të konstatoj gjendjen faktike lidhur me Xhaminë e cila ndodhet në lagjen urbane “Kalaja” Rr. “Istref Haziri” Nr. 9, duke gjetur një zgjidhje të qëndrueshme dhe duke adresuar shqetësimet e banorëve, që banojnë në lagjen e cekur më latë të shprehura përmes peticionit të parashtruar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

3. Komisioni i lartë cekur, obligohet të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate të kësaj problematike, konform legjislacionit në fuqi, duke i përligjur shqetësimet dhe interesat e banorëve të asaj lagje dhe pas përfundimit të këtij procesit të ofroj një raport të shkruar Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu




Kryesues i Kuvendit